



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA**

# **RAPORTI VJETOR 2021**

**Prishtinë, 2022**

**FJALA HYRESE E KRYETARIT TË KËSHILLIT TË PAVARUR  
MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**

Kam kënaqësinë të prezantoj Raportin vjetor të punës për vitin 2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Pavarësisht se edhe viti 2021 ka qenë sfidues për shkak të ndikimit të pandemisë COVID 19, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si institucion përgjegjës që siguron zbatimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil ka përmbyllur vitin 2021 me numër me të madh të lëndëve të shqyrtuara që nga themelimi i tij.

Gjatë vitit 2021 kemi ushtruar mandatin kushtetues dhe ligjor duke shqyrtuar dhe vendosur për 918 ankesa të parashtruara nga nëpunësit civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe paralelisht me shqyrtimin e ankesave kemi arritur të ushtrojmë me sukses edhe funksionin e monitorimit të institucioneve publike lidhur me zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil ku kemi realizuar 37 vizita monitoruese të rregullta dhe 2 vizitë monitoruese të jashtëzakonshme, me c'rast kemi evidentuar 252 shkelje të rregullave të shërbimit civil dhe rrjedhimisht janë dhënë 252 rekomandime për institucionet e administratës publike.

Këshilli me profesionalizëm dhe përkushtim është angazhuar që të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës publike duke dëshmuar në kontinuitet vendimmarrje të paanshme dhe profesionale në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Në këtë mënyrë është kontribuar në përmbushjen e mandatit të dhënë që shërbimi civil të jetë profesional dhe i paanshëm, si dhe të pasqyroj diversitetin e popullit të Kosovës, duke përfshirë parimin e barazisë gjinore.

Edhe pse numri i madh i ankesave të nëpunësve civil mbetet një nderë sfidat tona kryesore, ne vlerësojmë se ky numra nuk është vetëm si pasojë e shkeljeve me të shpeshta në shërbimin civil, por edhe një vetëdijesim me i madh i nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil që të shfrytëzojnë të drejtën e ankimit kur vlerësojnë ju kanë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës, si dhe një besim i shtuar në vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Andaj, falënderoj anëtarët e Këshillit për përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar, duke bërë që Këshilli të vendos për të gjitha ankesat brenda afateve të përcaktuara ligjore. Po ashtu, falënderoj bashkëpunëtorët profesional dhe nëpunësit tjerë të sekretarisë, të cilët kanë ofruar mbështetjen e tyre profesionale dhe administrative, fal të cilës kemi arritur që t'i realizojmë me sukses funksionet e Këshillit.

**Jeton KOCA**

**Kryetar i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

## 1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport përmban të dhëna dhe informata të detajuara lidhur me aktivitetet dhe punët e realizuara gjatë periudhës raportuese nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referiuar Këshilli*).

Në raport pasqyrohen informatat për punët dhe aktivitetet e kryera në kuadër të funksionit të zgjidhjes së ankesave të nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, si dhe aktivitetet lidhur me funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

Po ashtu ky raport përmban të dhëna përkitazi me aktivitetet që janë ndërmarr nga Sekretaria e Këshillit, në drejtim të hartimit të shkresave dhe pjesëmarrjes në përfaqësime gjyqësor.

Këshilli gjatë vitit 2021 ka pranuar gjithsejtë 884 ankesa të cilat janë parashtruar drejtpërdrejtë nga nëpunësit civilë, si dhe kandidatët për pranim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Përveç ankesave si me lartë, gjatë periudhës raportuese janë pranuar 328 aktgjykime nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ. Me këto aktgjykime është detyruar Këshilli që t'i shqyrtoj dhe të vendos për 328 ankesa, e për të cilat nuk është vendosur për arsye të mungesës së anëtarëve dhe rrjedhimisht mosfunksionimit të Këshillit. Njëkohësisht në periudhën raportuese janë pranuar edhe 23 aktgjykime përmes të cilave Këshilli është obliguar që t'i ri-shqyrtoj 23 vendime lidhur me ankesat e vendosura në vitet paraprake.

Andaj, bazuar si me lartë rezulton se gjatë periudhës raportuese Këshilli ka pasur për shqyrtim gjithsejtë 1235 ankesa.

Ndërsa në kuadër të funksionit të monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil janë realizuar 37 vizita të rregullta dhe 2 vizitë e jashtëzakonshme në institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë.

Në raportet e monitorimit të zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil për institucione të nivelit qendror dhe lokal, janë evidentuar dhe rrjedhimisht konstatuar 252 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara janë dhënë 252 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve përkatëse.

## 2. KORNIZA LIGJORE

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kryen funksionet dhe përgjegjësitë themelore në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, dhe aktet që derivojnë nga ky ligj;
- Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës;
- Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Rregulloren Nr.01/2018 për Punën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës;
- Rregulloren Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil;
- Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli, në ushtrimin e funksioneve themelore për sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, respekton aktet e veçanta të institucioneve të pavarura kushtetuese siç përcaktohet me Aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese KO171/18 të datës 20 maj 2019, dhe po ashtu zbaton ligjet e veçanta të institucioneve siç përcaktohet me nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë.

### 3. FUSHËVEPRIMI I KËSHILLIT

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është institucion i pavarur që siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe për punën e tij i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli si institucion i pavarur është paraparë me nenin 101 paragrafin 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Mbikëqyrja e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil bëhet përmes këtyre funksioneve themelore:

- *shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil;*
- *monitoron institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civil, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civilë.*

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve si me lartë, Këshilli mund të:

- vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- të ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil;
- të intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit;
- kërkon dhe merr nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij;
- organizon seanca profesionale; dhe
- nxjerr vendime, udhëzime qëndrime dhe rekomandime.

#### 4. ORGANIZIMI I KËSHILLIT


Organizimi i brendshëm i Këshillit është i rregulluar me Ligjin Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe me Rregulloren Nr.05/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është përcaktuar se Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente me mandat 7 vjeçar me pamundësi rizgjedhje, dhe se përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Republikës së Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë emërohen nga komunitetet joshqiptare, dhe së paku dy (2) anëtarë duhet të jenë të gjinisë femërore.

Në periudhën raportuese Këshilli ka pasur në përbërje vetëm me pesë (5) anëtarë të komunitetit shqiptar, prej tyre dy (2) anëtare të gjinisë femërore. Ndërsa numri i anëtarëve të komunitetit jo shqiptar ende nuk është plotësuar edhe përkundër tetimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të punës mbështetet nga Sekretaria, ku në kuadër të Sekretarisë funksionon Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Divizioni për Mbështetje Profesionale. Në strukturën organizative të Sekretarisë së Këshillit janë të aprovuara gjithsejtë 23 pozita të punës për nëpunës civilë, deri sa në periudhën raportuese të punësuar janë 21 nëpunës civilë.

**ORGANOGRAMI  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**



## 5. AKTIVITETET E KËSHILLIT PËR PËRIUDHËN RAPORTUESE

Në vijim të raportit janë përshkruar aktivitetet e realizara në kuadër të ushtrimit të funksioneve lidhur me procesin e shqyrtimit të ankesave, si dhe funksionin e monitorimit të institucioneve të administratës publike për zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

### 5.1.FUNKSIONI I SHQYRTIMIT TË ANKESAVE

Këshilli gjatë vitit 2021 ka pranuar gjithsejtë 884 ankesa të cilat janë parashtruar drejtpërdrejtë nga nëpunësit civilë, si dhe kandidatët për pranim në shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

Përveç ankesave si me lartë, gjatë periudhës raportuese janë pranuar 328 aktgjykime nga Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ. Me këto aktgjykime është detyruar Këshilli që t'i shqyrtoj dhe të vendos për 328 ankesa të parashtruara në vitet paraprake, e për të cilat nuk është vendosur për arsye të mos funksionalizimit konkretisht mos emërimit të anëtarëve të Këshillit. Njëkohësisht në periudhën raportuese janë pranuar edhe 23 aktgjykime përmes të cilave Këshilli është obliguar që t'i ri-shqyrtoj 23 vendime lidhur me ankesat e vendosura në vitet paraprake nga Këshilli.

Andaj, bazuar si me lartë rezulton se gjatë periudhës raportuese Këshilli ka pasur për shqyrtim gjithsejtë 1235 ankesa. Ndërsa gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe është vendosur për 918 ankesa.

Ky raport përmban të dhëna statistikore për ankesat e pranuar sipas:

- objektit të ankesës;
- strukturës gjinore të ankuesve;
- strukturës etnike të ankuesve; dhe
- institucioneve ndaj të cilave është paraqitur ankesë.




### 5.1.1. Ankesat sipas objektit

Këshilli gjatë periudhes raportuese ka pranuar ankesa me objekt të ndryshëm të ankimimit dhe të njëjtat janë ndarë dhe regjistruar sipas llojit të objektit. Ndarja e ankesave sipas objektit është pasqyruar në numra dhe në përqindje në tabelën në vijim:


**Tabela 1.** Ankesat e pranuar sipas objektit gjatë vitit 2021

Nr.	Objekti i ankesave	Numri i ankesave	Përqindja
1	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	425	34.41%
2	Kompensim material	310	25.10%
3	Kontestim konkursi	209	16.92%
4	Masë disiplinore	98	7.92%
5	Ndërprerje e marrëdhënies së punës	68	5.5%
6	Transferim	43	3.48%
7	Vlerësim i punës	33	2.67%
8	Shkelje e të drejtës në pagë	28	2.27%
9	Pezullim parandalues	12	0.97%
10	Ulje në pozitë (degradim)	3	0.24%
11	Pezullim i dakorduar	2	0.16%
12	Çështje të avancimit në karrierë	2	0.16%
13	Kundër caktimit të ushtruesve të detyres	1	0.08%
14	Mos vazhdim i kontratës së punës	1	0.08%
16	<b>Gjithsej</b>	<b>1235</b>	<b>100%</b>

Diagrami 1. Paraqitja grafike e të dhënave sipas tabelës nr.1



Vazhdim i diagramit nr.1



**5.1.2. Ankesat sipas strukturës gjinore**


Nga 1235 ankesa të pranuar, ndarja sipas strukturës gjinore është si në vijim:

- gjinisë mashkullore 820 ose 66.4%;
- gjinisë femërore 415 ose 33.6%.

**Tabela 2.** Ankesat sipas strukturës gjinore

Nr.	Ankesat sipas strukturës gjinore	Numri	Përqindja
1	Meshkuj	820	66.4%
2	Femra	415	33.6%

**Diagrami 2.** Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.2




### 5.1.3. Ankesat sipas strukturës etnike

Nga 1235 ankesa të pranuar, prej tyre 1208 ankesa ose 97.81% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë pranuar nga ankuesit e përkatësisë etnike shqiptare, 24 ankesa ose 1.94% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë pranuar nga ankuesit e përkatësisë etnike serbe, 2 ankesa ose 0.16% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë pranuar nga ankuesit e përkatësisë etnike boshnjake, dhe 1 ankesë ose 0.08% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë është pranuar nga ankuesi i përkatësisë etnike turke.

**Tabela 3.** Ankesat sipas strukturës etnike

Nr.	Ankesat sipas strukturës etnike	Numri i ankesave	Përqindja
1	Shqiptar	1208	97.81%
2	Serb	24	1.94%
3	Boshnjak	2	0.16%
4	Turk	1	0.08%

**Diagrami 3.** Paraqitja grafike e të dhënave sipas tabelës nr.3




#### 5.1.4. Ndarja e ankesave të pranuar sipas institucioneve

Nga 1235 ankesa të pranuar, 954 ankesa ose 77.25% e numrit të përgjithshëm të ankesave, janë ankesa të parashtruara ndaj institucioneve të administratës qendrore, ndërsa 281 ankesa ose 22.75% e numrit të përgjithshëm të ankesave janë ankesë të ushtruara ndaj institucioneve të administratës lokale.

**Tabela 4.** Ankesat e pranuar sipas institucioneve

Nr.	Ankesat e pranuar sipas institucioneve	Numri i ankesave	Përqindja
1	Institucionet e administratës qendrore	954	77.25%
2	Institucionet e administratës lokale	281	22.75%

**Diagrami 4.** Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.4



## 6. ANKESAT SIPAS INSTITUCIONEVE

### 6.1. Ankesat sipas institucioneve të administratës qendrore

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar për shqyrtim 954 ankesa ndaj institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim:

**Tabela 5.** Të dhënat lidhur me numrin dhe përqindjen e ankesave të pranuar kundër institucioneve të administratës qendrore

Nr.	Institucionet e Administratës Qendrore	Numri i Ankesave	Përqindja
1	Agjencia Kosovare e Privatizimit	156	12.63%
2	Policia e Kosovës	140	11.33%
3	Administrata Tatimore e Kosovës	77	6.23%
4	Ministria e Punëve të Brendshme	65	5.26%
5	Shërbimi Korrektues i Kosovës	38	3.07%
6	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	35	2.83%
7	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	32	2.59%
8	Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	32	2.59%
9	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	30	2.43%
10	Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë Tregtisë	27	2.18%
11	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	23	1.86%
12	Ministria e Shëndetësisë	18	1.45%
13	Universiteti i Prishtinës	17	1.37%
14	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	17	1.37%
15	Agjencia e Kosovës për Forenzikë	16	1.29%
16	Autoriteti i Aviacionit Civil	15	1.21%
17	Ministria e Ekonomisë	15	1.21%
18	Agjencia Pyjore e Kosovës	14	1.13%
19	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	12	0.97%
20	Këshilli Prokurorial i Kosovës	12	0.97%
21	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	12	0.97%
22	Zyra e Kryeministrit	9	0.73%
23	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	9	0.73%
24	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	9	0.73%
25	Këshilli i Sigurisë së Kosovës	6	0.48%
26	Ministria e Drejtësisë	6	0.48%
27	Gjykata Themelore në Prishtinë	5	0.40%
28	Komisioni i Pavarur për Media	5	0.40%
29	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	5	0.40%

30	Agjencia e Punësimit	4	0.33%
31	Biblioteka Kombëtare e Kosovës	4	0.33%
32	Gjykata e Apelit në Prishtinë	4	0.33%
33	Gjykata Supreme e Kosovës	4	0.33%
34	Inspektorati i Punës	4	0.33%
35	Shërbimi Sprovuesi Kosovës	4	0.33%
36	Universiteti i Pejës	4	0.33%
37	Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë	3	0.25%
38	Agjencia e Menaxhimit Emergjent	3	0.25%
39	Organi Shqyrtues i Prokurimit	3	0.25%
40	Ministria e Mbrojtjes	3	0.25%
41	Kuvendi i Republikës së Kosovës	3	0.25%
42	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	3	0.25%
43	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	3	0.25%
44	Institucioni i Avokatit të Popullit	3	0.25%
45	Gjykata Themelore në Mitrovicë	3	0.25%
46	Gjykata Themelore në Gjilan	3	0.25%
47	Autoriteti Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	3	0.25%
48	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	3	0.25%
49	Akademia e Drejtësisë	3	0.25%
50	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	2	0.16%
51	Agjencia e Statistikave të Kosovës	2	0.16%
52	Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale	2	0.16%
53	Agjencia Kadastrale e Kosovës	2	0.16%
54	Autoriteti Kosovar i Kongurrencës	2	0.16%
55	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	2	0.16%
56	Agjencia Kundër Korrupsionit	1	0.08%
57	Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës	1	0.08%
58	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	1	0.08%
59	Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit	1	0.08%
60	Dogana e Kosovës	1	0.08%
61	Gjykata Themelore në Ferizaj	1	0.08%
62	Gjykata Themelore në Prizren	1	0.08%
63	Inspektorati i Policisë së Kosovës	1	0.08%
64	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike	1	0.08%
65	Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1	0.08%
66	Njësia për Integjencë Financiare	1	0.08%
67	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia	1	0.08%
68	Presidenca e Kosovës	1	0.08%
69	Qendra e Studentëve	1	0.08%
70	Spitali Regjional i Gjakovës	1	0.08%
71	Universiteti i Mitrovicës	1	0.08%

72	Universiteti i Prizrenit	1	0.08%
73	Zyra Kombëtare e Auditimit	1	0.08%
<b>74</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>954</b>	<b>77.25%</b>

**Tabela 6.** Ankesat e pranuar kundër institucioneve të administratës qendrore sipas objektit të ankesave

Ankesat e pranuar kundër institucioneve të administratës qendrore sipas objektit të ankesës	Kërkesa nga mardhënia e punës	Kompensim material	Kontestim Konkursi	Masë disiplinore	Ndërprerje e mardhënies së punës	Shkelje e të drejtës në pagë	Pezullim parandalues	Tranferime	Vlerësim i punës	Kundër caktimit të U.D	Ujje në pozitë	Mos vazhdim i kontratës së punës	Çështje e avancimit në karrierë	Pezullim i dakorduar	Gjithsej
Agjencia Kosovare e Privatizimit	152	1	1	1	1										156
Policia e Kosovës	25	96		4	2	10		3							140
Administrata Tatimore e Kosovës	13	10	26	8	2	2		8	8						77
Ministria e Punëve të Brendshme	10	15	19	8	4		1	3	3				1	1	65
Shërbimi Korrektues i Kosovës	11	6	3	10	3		1	4							38
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	4	15	10	1		2	1	2							35
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	5	9	15		2					1					32
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	11	4	6	1	4		1	3	2						32
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	17	2	2	1	1		1	3		1	2				30
Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	6	9	1	1	4	2	1	2				1			27
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	9	7	3	1	3										23



Ministria e Shëndetësisë	3	5	3	2	2	2	1											18
Universiteti i Prishtinës		15		2														17
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	12	2	1		1					1								17
Agjencia e Kosovës për Forenzikë	10	3								3								16
Autoriteti i Aviacionit Civil	10	1		1						3								15
Ministria e Ekonomisë	7	2	2	3						1								15
Agjencia Pyjore e Kosovës	3	1	2	7					1									14
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural			7	1	2		1			1								12
Këshilli Prokurorial i Kosovës	1		4	1	2				3	1								12
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	3	2	3	4														12
Zyra e Kryeministrit	4	1	1	1	2													9
Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore	6		1							2								9
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës	2	3	2	2														9
Këshilli i Sigurisë së Kosovës	2	3		1														6
Ministria e Drejtësisë			1	4	1													6
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	4																5
Komisioni i Pavarur për Media	3		1					1										5
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	2	1	1	1														5
Agjencia e Punësimit	1	3																4
Biblioteka Kombëtare e Kosovës	2	1	1															4
Gjykata e Apelit në Prishtinë		4																4
Gjykata Supreme e Kosovës		3	1															4
Inspektorati i Punës	1	2			1													4
Shërbimi Sprovuesi Kosovës		2		1	1													4

Universiteti i Pejës			2	2													4	
Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë						3												3
Agjencia e Menaxhimit Emergjent		3																3
Organi Shqyrtues i Prokurimit			1	2														3
Ministria e Mbrojtjes	2				1													3
Kuvendi i Republikës së Kosovës	1	1	1															3
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	2	1																3
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve			2		1													3
Institucioni i Avokatit të Popullit	1	1	1															3
Gjykata Themelore në Mitrovicë		1	1	1														3
Gjykata Themelore në Gjilan	1		2															3
Autoriteti Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare	1	1						1										3
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	2				1													3
Akademia e Drejtësisë		2		1														3
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	1								1									2
Agjencia e Statistikave të Kosovës					1				1									2
Agjencia e Kosovës për Produkte Medicinale	1			1														2
Agjencia Kadastrale e Kosovës		2																2
Autoriteti Kosovar i Kongurrencës	1	1																2
Instituti i Kosovës për Administratë Publike									2									2
Agjencia Kundër Korrupsionit				1														1
Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës						1												1
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	1																	1

Autoriteti Rregullativ për Sherbimet e Ujit	1														1
Dogana e Kosovës		1													1
Gjykata Themelore në Ferizaj			1												1
Gjykata Themelore në Prizren		1													1
Inspektorati i Policisë së Kosovës			1												1
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike					1										1
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	1														1
Njësia për Integjencë Financiare		1													1
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa					1										1
Presidenca e Kosovës					1										1
Qendra e Studentëve		1													1
Spitali Regjional i Gjakovës			1												1
Universiteti i Mitrovicës		1													1
Universiteti i Prizrenit	1														1
Zyra Kombëtare e Auditimit			1												1
<b>Gjithsej</b>	<b>353</b>	<b>250</b>	<b>131</b>	<b>75</b>	<b>45</b>	<b>22</b>	<b>9</b>	<b>33</b>	<b>29</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>954</b>

## 6.2. Ankesat sipas institucioneve të administratës lokale

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka pranuar për shqyrtim 281 ankesa kundër institucioneve të administratës qendrore, të cilat pasqyrohen si në vijim.

**Tabela 7.** Të dhënat për numrin dhe përqindjen e ankesave të pranuar kundër institucioneve të administratës lokale.

Nr.	Institucionet e administratës lokale	Numri i ankesave	Përqindja
1	Komuna e Prishtinës	71	5.75%
2	Komuna e Gjakovës	18	1.45%
3	Komuna e Gjilanit	17	1.37%
4	Komuna e Shtimes	15	1.21%
5	Komuna e Mitrovicës	15	1.21%
6	Komuna e Ferizajt	13	1.05%
7	Komuna e Obiliqit	12	0.97%
8	Komuna e Podujevës	11	0.89%
9	Komuna e Prizrenit	10	0.80%
10	Komuna e Vitisë	10	0.80%
11	Komuna e Rahovecit	9	0.73%
12	Komuna Malishevës	8	0.65%
13	Komuna e Lipjanit	8	0.65%
14	Komuna e Kamenicës	8	0.65%
15	Komuna e Fushë Kosovës	8	0.65%
16	Komuna e Drenasit	7	0.56%
17	Komuna e Pejës	6	0.50%
18	Komuna e Kaçanikut	6	0.50%
19	Komuna Skenderajt	5	0.40%
20	Komuna e Leposaviqit	5	0.40%
21	Komuna e Klinës	4	0.33%
22	Komuna e Suharekës	4	0.33%
23	Komuna Vushtrisë	3	0.25%
24	Komuna e Istogut	3	0.25%
25	Komuna e Dragashit	2	0.16%
26	Komuna e Deçanit	1	0.08%
27	Komuna e Junikut	1	0.08%
28	Komuna e Graçanicës	1	0.08%
29	<b>Gjithsej</b>	<b>281</b>	<b>22.75%</b>

**Tabela 8.** Ankesat e pranuar kundër institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave

Ankesat e pranuar kundër institucioneve të administratës lokale sipas objektit të ankesave	Kontestim konkursi	Kompensim material	Ndërprenje e marrëdhënies së punës	Transferim	Masë disiplinore	Pezullim parandalues	Shkelje e të drejtës në pagë	Kërkesa nga marrëdhënia e punës	Vlerësim i punës	Pezullim i dakorduar	Çështje e avancimit në karrierë	Gjithsej
Komuna e Prishtinës	9	17	7	2	5	1		29			1	71
Komuna e Gjakovës	4	5	1	1	3			4				18
Komuna e Gjilanit	8	4	1		1			3				17
Komuna e Shtimes	1		1		1		1	11				15
Komuna e Mitrovicës	10	1	1		1			2				15
Komuna e Ferizajt	2	5		2				4				13
Komuna e Obiliqit		7	2		2			1				12
Komuna e Podujevës	4	1		2	3			1				11
Komuna e Prizrenit	3	1		2	1			3				10
Komuna e Vitisë	5	2				1	2					10
Komuna e Rahovecit	2	1	1		1		1	3				9
Komuna e Malishevës	6		1					1				8
Komuna e Lipjanit	1	4	1		1	1						8
Komuna e Kamenicës	3				2			2	1			8
Komuna e Fushë Kosovës		4					1	3				8
Komuna e Drenasit	2	2			1		1		1			7
Komuna e Pejës	1	1	1					1	2			6
Komuna e Kaçanikut	4	1	1									6
Komuna Skenderajt	1	2		1				1				5
Komuna e Leposaviqit		1	4									5
Komuna e Klinës	4											4
Komuna e Suharekës	3							1				4

Komuna e Vushtrisë			1					2				3
Komuna e Istogut	3											3
Komuna e Dragashit		1						1				2
Komuna e Deçanit		1										1
Komuna e Junikut										1		1
Komuna e Graçanicës					1							1
<b>Gjithsej</b>	<b>76</b>	<b>61</b>	<b>23</b>	<b>10</b>	<b>23</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>73</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>281</b>

## 7. NDARJA E ANKESAVE SIPAS MËNYRËS SË VENDOSJES

Këshilli, gjatë periudhës raportuese ka shqyrtuar dhe vendosur për gjithsej 918 ankesa, duke vendosur si në vijim:

### 7.1. Të aprovuara

Janë vendime me të cilat është konstatuar se pretendimet ankimore janë të bazuara dhe rrjedhimisht janë anuluar/shfuqizuar aktet e organeve të punësimit, duke i obliguar të njëjtat për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar **147** ankesa.

### 7.2. Pjesërisht të aprovuara

Janë vendime me të cilat është konstatuar se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara dhe rrjedhimisht janë anuluar/shfuqizuar apo ndryshuar aktet e organeve të punësimit, duke i obliguar të njëjtat për zbatimin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka aprovuar pjesërisht **35** ankesa.

### 7.3. Të refuzuara

Janë vendime me të cilat është konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesve nuk janë të bazuara dhe rrjedhimisht janë lenë në fuqi aktet apo veprimet e organeve të punësimit.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka refuzuar **438** ankesa.

### 7.4. Të hedhura poshtë si të palejuara

Janë vendime me të cilat është konstatuar se ankuesit paraprakisht nuk kanë ndërmarr veprime apo nuk i kanë shterur mjetet e brendshme të organi i punësimit, ankesat janë parashtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor për ankim, apo janë parashtruar nga personat të cilët në bazë të ligjit nuk kanë legjitimitetin e palës në procedurë.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka hedhur poshtë si të palejuara **89** ankesa.

### 7.5. Të shpallura jo-kompetent

Janë vendime me të cilat është konstatuar se ankuesit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil apo kandidatit për marrjen e statusit në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese është shpallur jo kompetent për **93** ankesa.

### 7.6. Detyrime

Janë vendime me të cilat është konstatuar se organi i punësimit pa të drejtë nuk ka nxjerr akt administrativ dhe rrjedhimisht palës ju kanë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka nxjerr **8** vendime me të cilat janë detyruar organet e punësimit, respektivisht organet kompetente që të nxjerrin akt administrativ sipas kërkesës së ankuesve.

### 7.7. Kthimi në rishqyrtim

Janë vendime me të cilat janë konstatuar të metat e aktit administrativ apo të metat tjera procedurale të cilat e kanë pamundësuar Këshillin që të vendos në mënyrë meritore.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për kthimin e lëndës në rishqyrtim për **27** ankesa.

### 7.8. Përfundim i procedimit administrativ

Janë vendime me të cilat është konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ për shkak se ankuesi ka tërhequr ankesën, objekti i vendosjes është bërë i pamundur apo i kotë, si dhe për çështjet tjera të përcaktuara shprehimisht me ligj.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për përfundimin e procedimit administrativ për **80** ankesa.

### 7.9. Të pezulluara

Janë vendime me të cilat është konstatuar se gjatë procedurës janë paraqitur çështje zgjidhja e të cilave është parakusht për zgjidhjen e çështjes kryesore.

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për pezullimin e **1** procedure.


Në vijim paraqiten në mënyrë tabelare të dhënat lidhur me mënyrën e vendosjes së ankesave sipas numrit dhe përqindjes.

**Tabela 9.** Mënyra e vendosjes së ankesave

Mënyra e vendosjes	Numri i ankesave	Përqindja
Të refuzuara	438	47.71%
Të aprovuara	147	16.01%
Shpallja jo kompetent	93	10.13%
Të hedhura poshtë si të palejuara	89	9.69%
Përfundim i procedimit administrativ	80	8.71%
Të aprovuara pjesërisht	35	3.81%
Kthimi në rishqyrtim	27	2.94%
Detyrim për vendosje	8	0.87%
E Pezulluar	1	0.10%
<b>Gjithsej</b>	<b>918</b>	<b>100%</b>



Diagrami 5. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.9



## 8. MËNYRAT E VENDOSJES SË ANKESAVE SIPAS INSTITUCIONEVE

Në këtë pjesë të raportit paraqiten të dhënat për mënyrën e vendosjes së ankesave të pranuar kundër institucioneve të administratës qendrore dhe lokale.

### 8.1. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara kundër institucioneve të administratës qendrore

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për **669** ankesa të parashtruara kundër institucioneve të administratës qendrore, si në vijim:

**Tabela 10.** Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara kundër institucioneve të administratës qendrore

Institucionet e Administratës Qendrore	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Kthimi në rishqyrtim	Përfundim procedimi	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	E Pezulluar	Numri i ankesave të shqyrtuara
Policia e Kosovës	4	59		6	28					97
Administrata Tatimore e Kosovës	21	28		2		8	15			74
Ministria e Punëve të Brendshme	13	29	1	5		2	10		1	61
Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	12	19		1		1	12			45
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës		9	4	5	5	4	5			32
Shërbimi Korrektues i Kosovës	6	10	2	3	5					26
Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	4	14		4	1		2			25
Ministria e Industrisë ndërmarrësisë dhe Tregtisë	2	14	1			3	2	2		24
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	13		5	1		2	1		23
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	5	14		1	1		1			22
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe	1	10			3					14

Sportit									
Agjencia Pyjore e Kosovës	1	11					2		14
Ministria e Shëndetësisë	2	7	1	1			2		13
Universiteti i Prishtinës		2		4	6				12
Ministria e Ekonomisë		4		7					11
Autoriteti i Aviacionit Civil	3	2	3	2					10
Zyra e Kryeministrit		8		1					9
Ministria e Drejtësisë	1	3			4				8
Agjencia Kosovare e Privatizimit	2	2		1			2		7
Këshilli Prokurorial i Kosovës	2	3	1			1			7
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	1	3		1	1				6
Gjykata e Apelit në Prishtinë	2	4							6
Komisioni i Pavarur për Media	2	4							6
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve			2	2		2			6
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror		3			1		2		6
Universiteti i Pejës	2	3	1						6
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal		3				2			5
Këshilli i Sigurisë së Kosovës	2	2					1		5
Agjencia e Punësimit		3	2						5
Akademia e Drejtësisë		5							5
Gjykata Themelore në Prishtinë		3	1	1					5
Gjykata Themelore në Mitrovicë		4			1				5
Inspektorati i Punës	2	2							4
Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë		2	1	1					4
Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	1		1				2		4
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	1	2					1		4
Gjykata Supreme e Kosovës		1		2					3
Agjencia Kadastrale e Kosovës		2					1		3
Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike		3							3
Kuvendi i Republikës së Kosovës		2		1					3
Agjencia Kosovës për Forenzikë			2			1			3
Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë					3				3
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa				2					2
Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	1			1					2
Gjykata Themelore në Gjiilan	2								2

Instituti i Kosovës për Administratë Publike	2									2
Akademia e Kosovës për Siguri Publike	1		1							2
Institucioni i Avokatit të Popullit		1			1					2
Agjencia Kosovare për Produkte Medicinale		2								2
Agjencia e Statistikave të Kosovës					1			1		2
Njësia për Intelgjencë Financiare		2								2
Presidenca e Kosovës	1	1								2
Shërbimi Sprovues Kosovës	1	1								2
Qendra e Studentëve të UP-së		2								2
Inspektorati i Policisë së Kosovës							1			1
Autoriteti Kosovar i Kongurrencës		1								1
Gjykata Themelore në Prizren		1								1
Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës		1								1
Zyra e Auditorit të Përgjithshëm					1					1
Organi Shqyrtues i Prokurimit						1				1
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale		1								1
Universiteti i Mitrovicës					1					1
Agjencia Kundër Korrupsionit	1									1
Agjencia e Menaxhimit Emergjent					1					1
Gjykata Themelore në Pejë							1			1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>102</b>	<b>325</b>	<b>24</b>	<b>59</b>	<b>65</b>	<b>25</b>	<b>61</b>	<b>7</b>	<b>1</b>	<b>669</b>

## 8.2. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara kundër institucioneve të administratës lokale

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka vendosur për 249 ankesa të parashtruara kundër institucioneve të administratës lokale, si në vijim:

*Tabela 11. Mënyrat e vendosjes së ankesave të parashtruara kundër institucioneve të administratës lokale*

Institucionet e Administratës Lokale	Të aprovuara	Të refuzuara	Pjesërisht të aprovuara	Të hedhura poshtë si të palejuara	Shpallja jo kompetent	Përfundim i procedimit administrativ	Ri-Shqyrtim	Detyrimi i organit administrativ për të nxjerr aktin administrativ	Numri i ankesave të shqyrtuara
Komuna e Prishtinës	10	20	3	4	9	2			48
Komuna e Gjilanit	1	13	1	1	5				21
Komuna e Mitrovicës		17		3		1			21
Komuna e Shtimes	2	11	2	1					16
Komuna e Gjakovës		7		3	1	4			15
Komuna e Malishevës				10		1			11
Komuna e Prizrenit	2	4		2	2				10
Komuna e Ferizajt	2	5			2	1			10
Komuna e Rahovecit	2		3		1	3			9
Komuna e Kamenicës	2	1		1	1	3			8
Komuna e Vitisë		5	2		1				8
Komuna e Lipjanit	6						1		7
Komuna e Leposaviqit	4	2					1		7
Komuna e Klinës	2	4				1			7
Komuna e Podujevës	6								6
Komuna e Vushtrrisë	1	4		1					6
Komuna e Fushë Kosovës		3		1	1			1	6
Komuna e Obiliqit	2	3							5
Komuna e Pejës		1		2	1	1			5
Komuna e Skenderajt		4				1			5
Komuna e Drenasit	1	1			1	1			4
Komuna e Suharekës		4							4
Komuna e Kaçanikut		3			1				4
Komuna e Kllokotit	1	1							2
Komuna e Graçanicës	1								1

Komuna e Istogut					1				1
Komuna e Deçanit					1				1
Komuna e Dragashit				1					1
<b>Gjithsejtë</b>	<b>45</b>	<b>113</b>	<b>11</b>	<b>30</b>	<b>28</b>	<b>19</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>249</b>

## 9.ZBATIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT NGA ORGANET E PUNËSIMIT

Në pajtim me dispozitat e nenit 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, organet e punësimit që kanë të punësuar nëpunës civil janë të obliguara të zbatojnë vendimet e Këshillit.

Vendimet e Këshillit janë vendime administrative të formës së prerë dhe duhet të zbatohen nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që ka nxjerrë vendimin e parë ndaj palës.

Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas legjislacionit për shërbimin civil në Republikën e Kosovës.

Organet e punësimit për vitin 2021 kanë pasur obligim ligjor për të zbatuar 217 vendime të Këshillit, prej tyre 182 vendime përfundimtare dhe 35 vendime të ndërmjetme, si në vijim:

- **147** vendime përfundimtare me të cilat janë aprovuar ankesat;
- **35** vendime përfundimtare me të cilat janë aprovuar pjesërisht ankesat;
- **8** vendime me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të nxjerrin akt administrativ;
- **27** vendime me të cilat organet e punësimit janë obliguar që të rishqyrtojnë vendimet e tyre.


Nga njoftimet që janë pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton se zbatimi i vendimeve përfundimtare të Këshillit është si në vijim:

Të zbatuara.....170 vendime  
 Të pa zbatuar.....5 vendime  
 Në process të zbatimit.....7 vendime  
 Të pezulluara nga gjykata.....3 vendime

**Tabela 12.** Zbatimi i vendimeve përfundimtare

Vendime përfundimtare	Numri i vendimeve	Vendime të zbatuara	Vendime të pa zbatuara	Vendime në proces të zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara
Të aprovuara	147	138	5	4	3
Pjesërisht të aprovuara	35	32	0	3	0
<b>Gjithsej</b>	<b>182</b>	<b>170</b>	<b>5</b>	<b>7</b>	<b>3</b>

**Diagrami 6.** Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.12



Nga njoftimet që janë pranuar nga organet e punësimit dhe ankuesit rezulton se zbatimi i vendimeve të ndërmjetme të Këshillit është si në vijim:


Të zbatuara.....33 vendime  
 Të pa zbatuar..... 1 vendim  
 Në process të zbatimit..... 1 vendime

**Tabela 13. Zbatimi i vendimeve të ndërmjetme**

Vendime të ndërmjetme	Numri i vendimeve	Vendime të zbatuara	Vendime të pa zbatuara	Vendime në proces të zbatimit	Numri i vendimeve të pezulluara
Kthimi në rishqyrtim	27	26	0	1	0
Detyrim për vendosje	8	7	1	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>35</b>	<b>33</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>0</b>



Diagrami 7. Paraqitja grafike e të dhënave si në tabelën nr.13



**Institucionet të cilat nuk kanë zbatuar vendimet e Këshillit:**

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhënat për institucionet e administratës qendrore dhe lokale të cilat nuk kanë zbatuar vendimet perfundimtare të Këshillit.

Tabela 14. Institucionet të cilat nuk i kanë zbatuar vendimet perfundimtare të Këshillit:

Nr.	Institucionet e administratës qendrore dhe komunale	Numri i vendimeve të pazbatuara	Numri referues i vendimit	Personi përgjegjes për zbatim
1	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë	1	A.nr.462/2021	Sekretari i Përgjithshëm
2	Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturor	1	A.nr.902/2021	Drejtori Ekzekutiv
3	Administrata Tatimore e Kosovës	2	A.nr.484/2021 A.nr.461/2021	Drejtori i Përgjithshëm
4	<b>Gjithsej</b>	<b>4</b>		

Në tabelën në vijim, paraqiten të dhënat për institucionet e administratës qendrore dhe lokale të cilat nuk kanë zbatuar vendimet e ndërmjetme të Këshillit.

**Tabela 15.** *Institucionet të cilat nuk i kanë zbatuar vendimet e ndërmjetme të Këshillit:*

Nr.	Institucionet e administratës qendrore dhe komunale	Numri i vendimeve të pazbatuara	Numri referues i vendimit	Personi përgjegjes për zbatim
1	Komuna e Leposaviqit	2	A.nr.209/2021 A.nr.338/2021	Kryetari i Komunes
2	<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>		

## 10. FUNKSIONI I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË RREGULLAVE DHE PARIMEVE TË LEGJISLACIONIT PËR SHËRBIMIN CIVIL

Këshilli gjatë periudhës raportuese ka ushtruar funksionin e monitorimit në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3 dhe nenit 20 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke mbikëqyrur zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil në fushat si në vijim:

- Organizimi i brendshëm dhe të dhënat e të punësuarve;
- Procedurat e rekrutimit dhe të avancimit;
- Procedurat disiplinore;
- Procedurat e ankesave;
- Procedurat e vlerësimit;
- Procedurat e pushimeve;
- Procedurat e transferimit;
- Të dhënat lidhur me përfaqësimin etnik, gjinor dhe personave me aftësi të kufizuara;
- Procedurat e pezullimit, ndërprerjes dhe përfundimit të marrëdhënies së punës;
- Papajtueshmëria në mes të ushtrimit të detyrës së nëpunësit civil dhe funksionarit publik;
- Të dhënat nëse ndaj nëpunësve civil është duke u zhvilluar procedurë penale apo është i dënuar me vendim të gjykatës;
- Rastet e ngacmimit seksual;
- Trajnimi i nëpunësve civil;
- Vijimi në punë, pagat, shtesat dhe kompensimet e nëpunësve civil;
- Zbatimi i rekomandimeve dhe vendimeve të Këshillit;

Këshilli në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregullores Nr.04/2018 për Procedurën e Monitorimit të Institucioneve të Administratës Publike lidhur me Zbatimin e Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil, me datë 26.01.2021 përmes Vendimit me numër 02/2021 ka aprovuar Planin e Monitorimit për vitin 2020.

Sipas planit të monitorimit, Këshilli gjatë vitit 2021 ka realizuar 39 vizita monitoruese në institucionet qendrore dhe lokale. Të gjeturat dhe rekomandimet e evidentuara gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil janë përfshirë në kuadër të Raporteve të Monitorimit për institucionet përkatëse.

Në raportet e monitorimit lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil janë evidentuar dhe rrjedhimisht konstatuar 252 shkelje të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, dhe për shkeljet e evidentuara janë dhënë 252 rekomandime për zyrtarët përgjegjës të institucioneve të cilat janë monitoruara.

**Tabela 16.** *Institucionet të cilat janë monitoruar gjatë periudhës raportuese*

Nr.	Institucionet e administratës qendrore dhe lokale të monitoruara	Numrit i të gjeturave	Numri i rekomandi meve
1	Administrata Tatimore e Kosovës	15	14
2	Agjencia e Akreditimit të Kosovës	4	4
3	Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Medicinale	8	8
4	Agjencia e Punësimit	6	6
5	Agjencia e Statistikave të Kosovës	6	6
6	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë	5	5
7	Agjencia e Zhvillimit të Bujqësisë	6	6
8	Agjencia Kadastrale e Kosovës	7	7
9	Agjencia Kundër Korrupsionit	5	5
10	Agjencia për Informim dhe Privatësi	4	4
11	Agjencia për Verifikim dhe Krahasim të Pronës	7	7
12	Agjencia Pyjore e Kosovës	6	6
13	Akademia e Kosovës për Siguri Publike	8	8
14	Autoriteti i Aviacionit Civil	5	6
15	Autoriteti Kombëtarë i Kualifikimeve	5	5
16	Inspektorati Shëndetësorë	7	7
17	Instituti i Kosovës për Administratë Publike	4	4
18	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	2	2
19	Komuna e Drenasit	6	6
20	Komuna e Ferizajt	7	8
21	Komuna e Gjakovës	8	8
22	Komuna e Gjilanit	11	11
23	Komuna e Klllokotit	6	6
24	Komuna e Mitrovicës së Jugut	8	8
25	Komuna e Pejës	4	4
26	Komuna e Podujevës	20	20
27	Komuna e Prizrenit	9	8
28	Kuvendi i Kosovës	3	3
29	Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	4	4
30	Ministria e Drejtësisë	10	10
31	Ministria e Financave Punës dhe Transfereve	5	5
32	Ministria e Industrisë ndërmarrësisë dhe Tregëtisë	6	6
33	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	6	6
34	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	7	7
35	Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës	7	7
36	Organi Shqyrtues i Prokurimit	6	6
37	Presidenca e Kosovës	6	6

38	Zyra e Kryeministrit	3	3
39	Gjithsej	252	252

## 11. SFIDAT DHE REKOMANDIMET E KËSHILLIT

### Mosfuksonimi i Këshillit për shkak të mungesës së anëtarëve

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në periudhën 21.01.2019-10.10.2020 dhe periudhën 01.07.2021-02.11.2021 nuk ka qenë funksional si rezultat i mungesës së anëtarëve të Këshillit.

Gjatë kësaj periudhe kohore nëpunësit civil dhe kandidatet për praninë në shërbimin civil të cilët kanë parashtruar ankesë në Këshill, janë udhëzuar nga Sekeratria e Këshillit lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në Gjykatë.

Me funksionalizimin e këtij institucioni, gjegjësisht me emërimin e anëtarëve të Këshillit me datë 10.10.2020, Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes aktgjykimeve detyruese është duke obliguar Këshillin që të vendos për të gjitha ankesat e palëve të cilat në mungesë të vendosjes nga Këshilli kanë iniciuar konflikt administrativ.

Rrjedhimisht, rrethanat si me lartë kanë ndikuar në rritjen enorme të ankesave për shqyrtim dhe vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, duke marr parasysh faktin se vetëm në periudhën raportuese Gjykata ka nxjerrë 328 aktgjykime me të cilat ka detyruar Këshillin që të shqyrtoj dhe vendos lidhur me 328 ankesa të nëpunësve civil.

### Funksionimi në përbërje jo të plotë

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 10.10.2020 është duke funksionuar me vetëm 5 anëtar të komunitetit shqiptar, ndërsa 2 anëtar të komunitetit jo shqiptar ende nuk janë përzgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Andaj, duke marr parasysh numrin e madh të ankesave për shqyrtim dhe vendosje, përbërja jo e plotë e anëtarëve mbetet sfidë në ushtrimin e mandatit kushtetues dhe ligjor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

### Stafi mbështetës dhe mungesa e hapësirave për punë efektive

**Stafi mbështetës** - Rritja e numrit të ankesave nderë vite ka imponuar kërkesën për rritjen e numrit të stafit mbështetës. Këshilli gjatë përgatitjes dhe amendamentimit të ligjit të buxhet në vazhdimësi ka dërguar kërkesa për rritjen e numrit të pozitave për rekrutimin e stafit mbështetës dhe rrjedhimisht një kërkesë e tillë është përsëritur edhe me rastin e hartimit të Qarkores së parë buxhetore për vitin 2023-2025. Andaj, aprovimi i kërkesës buxhetore për rritjen e numrit të stafit mbështetës do të ndikoj në ushtrimin e funksioneve në mënyrë efektive dhe efikase.

**Hapësirat e punës** – Sekretaria e Këshillit është e vendosur në një hapësirë të vogël të ish ndërtesës së Gërmisë. Kjo hapësirë e punës nuk është e mjaftueshme në raport me numrin e stafit aktual dhe njëkohësisht kushtet e punës janë tejet të vështira dhe si i tillë ambienti nuk krijon mundësi për punë efektive. Andaj, krijimi i kushteve të punës përmes sigurimit të hapësirave të

nevojshme ku stafi mbështetës ushtrojnë detyrat dhe përgjegjësitë e tij, si dhe sigurimi i hapësirave për mbajtjen e seancave publike me rastin e shqyrtimit të ankesave dhe seancave profesionale, do të lehtësoj ushtrimin e mandatit kushtetues dhe ligjor dhe rrjedhimisht do të jetë garancë për punë efektive dhe efikase.

## 12. VENDIMET E GJYKATAVE

Këshilli ka pranuar 140 aktvendime për të dhënë përgjigje në paditë e ushtruara kundër vendimeve të Keshillit dhe 230 ftesa për seanca gjyqësore. Janë pranuar 502 aktgjykime dhe 72 aktvendime.

Nga Gjykata Themelore janë pranuar gjithsej 498 vendime, nga të cilat 450 aktgjykime dhe 48 aktvendime.

Aktgjykimet e Gjykatës Themelore janë si vijon:

- Me 16 aktgjykime janë aprovuar paditë dhe janë anuluar 16 vendime të Keshillit;
- Me 80 aktgjykime janë refuzuar paditë dhe janë vërtetuar 80 vendime të Keshillit;
- Me 23 aktgjykime janë aprovuar padia e paditësve dhe lëndët janë kthyer në rishqyrtim të Keshillit;
- Me 3 aktgjykime janë aprovuar pjesërisht paditë e paditësve dhe janë anuluar vendimet e Keshillit;
- Me 328 aktgjykime janë anuluar njoftimet e Keshillit, dhe është obliguar Këshilli t'i shqyrtoj ankesat e pavendosura;

Aktvendimet e Gjykatës themelore janë si vijon:

- Me 11 aktvendime janë hedhur poshtë paditë e ushtruara dhe janë vërtetuar vendimet e Keshillit.
- Me 2 aktvendime aprovim;
- Me 2 aktvendime refuzim;
- Me 15 aktvendime janë pezulluar 15 procedura Gjyqësore.
- Me 3 aktvendime është shtyrë ekzekutimi i vendimit të Keshillit.
- Me 7 aktvendime janë refuzuar kërkesat për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të Keshillit.
- Me 1 aktvendim është ndërprere procedura gjyqësore për shkak të vdekjes së paditësit;
- Me 6 aktvendime janë korrigjuar aktgjykimet gjegjësisht aktvendimet gjyqësore;
- Me 1 aktvendim është hedhë poshtë kërkesa për shtyrje të ekzekutimit;

Nga Gjykata e Apelit në vitin 2021 janë pranuar 39 aktgjykime dhe 23 aktvendime, si në vijim:

- Me 28 Aktgjykime janë refuzuar 28 ankesat e ushtruara kundër vendimeve të Keshillit;
- Me 1 aktgjykim është aprovuar ankesa e paditësit dhe lënda është kthyer në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë;
- Me 6 aktgjykime janë refuzuar ankesat e Keshillit;

- Me 2 aktgjykime janë aprovuar ankesat e Këshillit;
- Me 2 aktgjykime lëndët janë kthyer në rishqyrtim në Këshill;

Aktvendimet e pranuar nga Gjykata e Apelit për vitin 2021 janë si vijon:

- Me 2 aktvendime aprovohet ankesa e Këshillit, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë;
- Me 5 aktvendime aprovohet ankesa e palës, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore dhe lënda kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë;
- Me 8 aktvendime refuzohet ankesa (padi) vërtetohet vendimi i Gjykatës Themelore;
- Me 2 aktvendimet është hedhë poshtë ankesa e paditësit;
- Me 4 aktvendime është refuzuar kërkesa për shtyrje të ekzekutimit;
- Me 1 aktvendim është refuzuar ankesë e Këshillit;
- Me 1 aktvendim miratohet ankesa e Këshillit.

Nga Gjykata Supreme për vitin 2021 kemi pranuar gjithsejtë 14 aktgjykime dhe 1 aktvendim:

Aktgjykimet e pranuar nga Gjykata Supreme:

1. Refuzohet ankesa e paditësit – 13 aktgjykime;
2. Aprovohet ankesa dhe lënda kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së parë – 1 aktgjykim; dhe
3. Aprovohet ankesa dhe lënda kthehet në rishqyrtim në gjykatën e shkallës së dytë – 1 aktgjykim.

Aktvendimet e pranuar nga Gjykata Supreme:

1. Me 1 aktvendim është hedhë poshtë kërkesa e palës.

Gjatë vitit 2021 kemi pranuar një Aktvendim nga Gjykata Themelore në Gjilan me të cilin është shpall jo kompetent për të trajtuar lëndën e palës.

### 13. VLERËSIME DHE REKOMANDIME

Këshilli, duke u mbështetur në të dhënat e siguruar nga ushtrimi i funksioneve kushtetuese dhe ligjore, gjegjësisht shqyrtimit të ankesave si dhe përmes monitorimit të institucioneve të administratës publike ka arritur që të identifikoj të gjetura lidhur me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, dhe rrjedhimisht ka adresuar rekomandime në raportet e veçanta të institucioneve të monitoruara.

Këshilli vlerëson se ndryshimet në legjislacionin e shërbimit civil gjegjësisht hyrja në fuqi e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe vonesa në nxjerrjen e akteve nënligjore si dhe mos funksionalizimi me kohë i Sistemit elektronik të Menaxhimit të Zyrtarëve Publikë, ka qenë një nga sfidat bazë që kanë përcjellë institucionet e administratës publike në funksionimin dhe ushtrimin e përgjegjësi të tyre.

Këshilli vlerëson se:

*Kuvendi dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, duhet të ndërmarr veprime në drejtim të plotësisht dhe ndryshimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë, sipas kërkesave të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese. Gjatë plotësisht dhe ndryshimit të këtij ligji t'i jepet rendësi fushëveprimit dhe çështjes përkritazi me ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe organizative të institucioneve të pavarura kushtetuese.*

*Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ministria përgjegjëse për administratë publike të ndërmarrin veprime për harmonizimin e akteve nënligjore me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, sepse gjatë shqyrtimit të ankesave dhe procesit të mbikëqyrjes së rregullave dhe parimeve të shërbimit civil është konstatuar se disa prej akteve nën ligjore nuk janë në harmoni me Ligjin për Zyrtarët Publikë.*

*Ministria përgjegjëse për administratë publike të siguroj përdorimin dhe raportimin e vazhdueshëm të dhënave në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) për institucionet e administratës publike.*

*Ministria përgjegjëse për administratë publike dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publikë në kuadër të planit vjetor të trajnimeve të përfshijnë module lidhur me ndryshimet ligjore të legjislacionit për shërbimin civil për të siguruar se ndryshimet ligjore janë të kuptueshme dhe zbatuara nga të gjithë nëpunësit civilë.*

*Këshilli vlerëson se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të ndërmarr veprime për harmonizimin e ligjeve të veçanta përkritazi me organizimin dhe funksionimin e Agjencioneve Ekzekutive konform dispozitave të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës shtetërore dhe Agjencioneve të Pavarura.*

*Qeveria e Republikës së Kosovës gjegjësisht Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, si dhe Ministria e Drejtësisë të ndërmarrin veprime për nxjerrjen e akteve të veçanta për rregullimin e*



*marrëdhënies se punës për nëpunësit civil me status të veçantë të punësuar në institucionet përkatëse për aq sa lejojnë dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik.*

*Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria përgjegjëse për administratë publike të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme që të hartohet katalogu lidhur me kategorizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin civil. Këshilli ka gjetur se ka shumë raste kur për të njëjtën pozitë dhe përshkrim të njëjtë të punës, nëpunësi paguhet më pagë të ndryshme, psh pozita Certifikues, Zyrtar Ligjor etj.*

*Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të angazhohen me shumë në përfaqësimin e gjinisë femërore në pozita të nivelit drejtues në shërbimin civil në nivel qendror dhe lokal.*

*Ministria e Punëve të Brendshme dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprime lidhur me përfaqësimin e gjinisë femërore në pozita të nivelit të lartë drejtues sepse përfaqësimi i gjinisë femërore në këtë nivel të përfaqësimit në shërbimin civil është minimal dhe si rrjedhojë nuk është në pajtim me parimin e barazisë gjinore.*

*Institucionet e administratës publike pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Zyrtar publik kanë qenë të obliguara që të bëjnë deklarinë e statusit të zyrtarëve publikë. Këshilli gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të parimeve dhe rregullave të legjislacionit për shërbimin civil ka konstatuar se shumë nga institucionet qendrore të mbikëqyrura nuk kanë finalizuar procesin e deklarinës të statusit të nëpunësve për arsye të mos konfirmimit të listave dhe mos bashkëpunimit të duhur të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik me institucionet përkatëse.*

*Qeveria e Republikës së Kosovës gjegjësisht Ministria gjegjëse të themeloj Komisionin Mjekësor lidhur me konstatimet e gjendjes shëndetësore të nëpunësve civil në rastet kur nëpunësi civil kërkon të transferohet për shkak të gjendjes së tij shëndetësore. Këshilli me rastin e vendosjes së ankesave ka konstatuar mungesën e një komisioni të tillë.*

*Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministria përgjegjëse për administratë publike dhe Ministria e Financave, të ndërmarrin të gjitha veprimet për ndalimin e shtesave dhe kompensimeve tjera për nëpunësit civilë, që janë në kundërshtim me dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë, dhe që të garantojnë që ato realizohen në pajtim me legjislacionin në fuqi. Të gjithë titullarët e institucioneve të administratës publike, të gjitha shtesat në pagë ti lejojnë vetëm në bazë të dispozitave të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civilë.*

*Institucionet e administratës publike qendrore dhe lokale t'i ndërmarr veprimet e duhura ligjore në mënyrë që t'ju jepet mundësia e punësimit personave me aftësi të kufizuara dhe të plotësohet kuota e përcaktuar me nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara.*

*Të gjithë titullarët e institucioneve të administratës publike të ndërmarrin të ndërmarrin veprime për identifikimin e fushave të trajnimit të nevojshme për nëpunësin civil, duke u mbështetur në*

*aftësitë e treguara të nëpunësit civil dhe në vlerësimin e bërë nga vlerësuesi;*

*Të gjithë titullarët e institucioneve të administratës publike të ndërmarrin të ndërmarrin veprime për themelimin e Komisionit disiplinor në pajtim me nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Zyrtaret Publikë dhe nenin 10 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullore (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.*

## 14. KRAHASIMI I PUNËS SË KËSHILLIT PËR VITIN 2021 ME PUNËN E KËSHILLIT PËR VITIN 2020

### 14.1. Funkzioni i shqyrtimit të ankesave

Në tekstin në vijim do të paraqiten të dhënat për punën e Këshillit për vitin 2021 në krahasim me punën e Këshillit për vitin 2020, në pajtim me kërkesën dhe formatin e raportit të punës.

Në vitin 2021 në Këshill janë pranuar gjithsej 884 ankesa, kurse në vitin 2020 në Këshill janë pranuar 444 ankesa. Nga kjo e dhënë, konstatohet që në Këshill gjatë vitit 2021 janë pranuar 440 ankesa më shumë se ankesat e pranuar në vitin 2020.

Duke marr parasysh numrin e ankesave të pranuar në vitin 2021, prej 884, si dhe 328 aktgjykime dhe 23 ri-shqyrtime që gjithsejt janë 1235, këshilli ka pasur në shqyrtim gjithsejt 1235 ankesa ku prej tyre ka vendosur për 918, ndërsa në vitin 2020 ka pasur në shqyrtim 444 ankesa prej të cilave ka vendosur për 241 ankesa.

Këshilli, gjatë vitit 2021 ka pasur në shqyrtim 1235 ankesa dhe prej tyre ka vendosur për 918 ankesa, në krahasim në vitin 2020 kur ka pasur në shqyrtim 1147 ankesa, prej të cilave ka vendosur për 241 ankesa. Nga kjo rezulton që Këshilli gjatë vitit 2021 ka vendosur për 677 ankesa më shumë se sa në vitin 2020.

Në vitin 2021 organet e punësimit kanë pasur për obligim zbatimin e 217 vendimeve të Këshillit, prej 217 vendimeve, organet e punësimit kanë zbatuar 203 vendime, nuk kanë zbatuar 6 vendime, ndërsa në proces të zbatimit janë edhe 8 vendime, dhe 3 vendime janë pezulluar me vendim të gjykatës.

Nr.	Ankesat/Vendimet	Viti 2021	Viti 2020	Ndryshimi	Krahasimi i ankesave dhe vendimeve në mes të vitit 2021 dhe 2020
1.	Ankesat pranuar	884	444	440	Këshilli në vitin 2021 ka pranuar 440 ankesa më shumë se në vitin 2020
2.	Ankesat për shqyrtim në Këshill	1235	1147	88	Këshilli në vitin 2021 ka pasur në shqyrtim 88 ankesa më shumë se në vitin 2020
3.	Ankesat e shqyrtuara në Këshillit (Numri i vendimeve)	918	241	677	Këshilli në vitin 2021 ka nxjerrë 677 vendime më shumë se në vitin 2020
4.	Vendimet e obligueshme për zbatim	217	94	123	Organet e punësimit në vitin 2021 kanë pasur obligim për zbatimin e 217 vendimeve, ndryshimi nga viti 2021 vitin 2020 është për 123 vendime.

5.	Vendimet zbatuara	e	203	73	130	Numri i vendimeve te zbatuara është 130 më shumë se në vitin 2020.
6.	Vendimet pazbatuara	e	6	4	2	Në vitin 2021 kan qenë 2 vendime të pazbatuara më shumë se në vitin 2020.

## 15. RAPORTI PËR SHPENZIMIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT

Buxheti fillestar i aprovuar për Këshillin, sipas Ligjit 07/L-041 per Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 ka qenë në shumën prej: 377.235.00 Euro. Buxheti si në SIMFK për vitin 2021, ka qenë në shumën prej: 317.602.24.00 Euro.

Sipas ligjit, buxheti i Këshillit është i ndarë në këto kategori ekonomike, si në tabelë nr.24.

**Tabela 17. Ndarja dhe alokimi i mjeteve sipas kategorive ekonomike**

Nr	Kategoritë Ekonomike	Buxheti fillestar aprovuar sipas Ligjit 07/L-041 A	Buxheti i rishikuar sipas ligjit nr,-08/L-016 B	Ndryshimi C=A-B	Buxheti Final-SIMFK D=B
1	<b>Paga dhe mëditje</b>	270.181.00	239.483.92	30.697.08	239.483.92
2	<b>Mallra dhe shërbime</b>	103.229.00	76.228.73	27.000.27	76.228.73
3	<b>Shpenzime komunale</b>	3.825.00	1.889.59	1.935.41	1.889.59
4	<b>Shpenzime kapitale</b>	00	00	00	00
	<b>Totali</b>	<b>377.235.00</b>	<b>317.602.24</b>	<b>59.632.76</b>	<b>317.602.24</b>

Nga pasqyra e cekur më lartë, shohim se ka ndryshim në mes të buxhetit fillestar (ndarja), dhe buxhetit final (SIMFK), në shumë prej: **59.632.76** euro.

Ky ndryshim ka ndodhë si vijon:

Në kategorinë **paga dhe shërbime** Këshillit ju ka shkurtua buxheti në shumë prej:.....30.697.08€

Në kategorinë **mallra dhe shërbime** Këshillit ju ka shkurtua buxheti në shumë prej:.....27.000.27€

Në kategorinë **shpenzime komunale** Këshillit ju ka shkurtua buxheti në shumë prej:..... 1.935.41€

Këshilli gjatë vitit 2021 ka pas një kursim të mjeteve në shumen prej 59.632.76 €, ky kursim ka ardhur si rrjedhojë e mos perzgjedhjes se anetarve (dy anetar te komunitetit jo shqiptar) nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në fund të vitit 2021, perms Vendim nr.21/50 dhe 11/52/2021 të dates 23.12.2021 të Qeverise se Republikes se Kosoves, nga buxheti i Keshillit janë marr mjetet finaciar në Shumen prej: **59.632.76** €, si vijon:

Nga kategoria paga dhe shtesa mjete në shumë prej:.....30.697.08€

Nga kategoria mallra dhe shërbime mjete në shumë prej:.....27.000.27€

Nga kategoria shërbime komunale mjete në shumë prej:.....1.935.41€

**Tabela 18. Shpenzimet e buxhetit sipas kategorive ekonomike**

Nr.	Kodi buxhetor 249	Buxheti final 2021	Buxh.i zvogëluar Me vendim Qev.	Buxheti si në SIMFK	Buxheti i shpenzuar	Të shprehura në %
1	<b>Paga dhe mëditje</b>	239.483.92	30.697.08	239.483.92	239.483.92	100%
2	<b>Mallra dhe shërbime</b>	76.228.73	27.000.27	76.228.73	68.632.15	90.%
3	<b>Shpenzime komunale</b>	1.889.59	1.935.41	1.889.59	1.889.59	100%
4	<b>Shpenzime kapitale</b>	00	00	00	00	00%
5	<b>Totali</b>	<b>317.602.24</b>	<b>59.632.76</b>	<b>317.602.24</b>	<b>310.005.66</b>	<b>97.61%</b>

Gjatë vitit 2021, nga buxheti si në SIMFK, Këshilli ka shpenzuar në total: 97.61 % të buxhetit.

Buxheti i shpenzuar në kategoritë ekonomike është si vijon:

**Në kategorinë ekonomike Paga dhe Mëditje:.....100%**

**Në kategorinë ekonomike Mallra dhe Shërbime:.....90.00%.**

**Në kategorinë ekonomike Shpenzime komunale:.....100 %**

**P.S. Ky Raport nuk është Aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.**